



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.10, datë 14/05/2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “ARDENO” SH.P.K, ME
VENDNDODHJE: MEZEZ, BASHKIA TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme, të subjektit “Ardeno” sh.p.k, me vendndodhje: Mezez, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi):

- X= 480111
- Y= 4579428
- Z= 68 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.3 \text{ l/sek}$ ($8.64 \text{ m}^3/\text{ditë}$)
- Qëllimi i përdorimit : Për qëllime sanitare.
- Thellësia e pus-shpimit: 65 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 40 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X = 480034.6;$

$Y = 4579405.9;$

$Z = 67.5 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.3 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

